
TERMAT E REFERENCËS

**KRIJIMI I BRENDIT RAJONAL PËR RAJONIN
EKONOMIK PERËNDIM, I BAZUAR NË
VLERAT E PËRBASHKËTA TË TRASHËGIMISË
KULTURORE**



CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO

 Sweden
Sverige

SFONDI

Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB Kosova) në bashkëpunim me gjashtë (6) komunitat e rajonit ekonomik perëndim (Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë, Pejë) po punojnë drejt zbatimit të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Rajonit Ekonomik Perëndim përmes Trashëgimisë Kulturore 2020-2023. Veprimet dhe aktivitetet e parapara përmes këtij dokumenti tentojnë të ripozicionojnë rolin e kulturës për rajonin ekonomik perëndim në zhvillimin gjithpërfshirës përmes bashkëpunimit multi-sektoral ndër-komunal. Objektivi Specifik 1, përkatësisht “Ruajtja e integritetit dhe autenticitetit të aseteve të trashëgimisë kulturore” parashihet të arrihet përmes një sërë veprimesh, ndër to është listuar “Krijimi i brendit rajonal me përfshirje të identitetit vizuel dhe aktiviteteve promovuese dhe vetëdijësuese”. Brendimi rajonal është një nga mënyrat për promovim të rajonit duke u bazuar në potencialet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e kulturor.

Me realizimin e aktiviteteve të parapara me brendimin e rajonit parashihet ngritja e numrit të vizitorëve në lokacionet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në rajonin e Dukagjinit si dhe fuqizimi dhe ngritja e ekonomive familjare të rajonit duke kontribuar në krijimin e një modeli të vetqëndrueshëm ekonomik rajonal të bazuar në kulturë e trashëgimi kulturore.

Projekti synon të:

- Krijoj identitetin vizuel të rajonit të Dukagjinit bazuar në karakteristikat e përbashkëta kulturore;
- Shndërroj identitetin vizuel në markën turistike të rajonit;
- Promovoj asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Dukagjinit;
- Promovoj bizneset e akomodimit dhe të produkteve ushqimore në rajon;
- Promovoj zejet karakteristike të zonës;
- Promovoj artin dhe organizatat kulturore të rajonit;
- Promovoj aktivitetet kulturore dhe festivalet në rajon.

QËLLIMI I DETYRËS

CHWB Kosova po kërkon të angazhojë një kompani të kualifikuar dhe me përvojë profesionale që të marr përsipër detyrat dhe aktivitetet e përshkruara më poshtë për krijimin e identitetit vizuel të rajonit ekonomik perëndim sipas potencialeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

DETYRAT DHE PRODUKTET

DETYRAT:

Faza 1:

- Identifikimi i të gjitha palëve të interesit dhe profilizimi i target audiencës.
- Propozimi mbi Strategjinë e Brendimit duke u bazuar nga të dhënat e mbledhura mbi audiencën e synuar, përfshirë identitetin vizuel, ndjesinë dhe gjuhën/të shprehurit.

Faza 2:

- Krijimi i udhërrëfyesit (brandbook) të brendit rajonal me përfshirje të materialeve promovuese.
- Krijimi i udhërrëfyesit të vizibilitetit, për prezantim në media sociale dhe kanale të tjera të komunikimit.
- Propozimi për përdorimin e identitetit vizuel në:
 - Aktivitete kulturore – festivale, ngjarje edukative, panaire etj..
 - Shenjëzim të aseteve të identifikuar të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
 - Brendim të produkteve lokale – gastronomi, artizanale etj.
 - Forma për prezantim në ppt..

PRODUKTET:

	PRODUKTET	Data për dorëzim
1.	Dorëzimi i planit të punës i cili përshkruan se si do të zbatohet puna	08.07.2021
2.	Dorëzimi i tre propozimeve për brendim/identiteti vizuel	15.07.2021
3.	Dorëzimi i Koncept Dokumentit për Strategjinë e Brendimit.	31.07.2021
4.	Dorëzimi i Koncept Dokumentit për Strategjinë për media sociale dhe kanale të tjera të komunikimit.	23.08.2021
5.	Dorëzimi i udhërrefyesit (brandbook) të brendit rajonal me pëfshirje të materialeve promovuese.	15.10.2021
6.	Dorëzimi i raportit final	31.10.2021

KOHËZGJATJA E DETYRËS

Aktivitetet e përshkruara duhet të përfundohen në afat prej katër (4) muaj nga data e fillimit të Kontratës. Faza një (1) zbatohet në këtë interval kohor: 01.07.2021 – 31.07.2021. Faza dy (2) zbatohet në këtë interval kohor: 01.08.2021-31.10.2021.

RAPORTIMI

Kompania e përzgjedhur duhet të punoj ngushtë me menaxherin e Kontratës nga CHWB Kosova, të marr këshilla dhe udhëzime në zbatimin e aktiviteteve të parapara. Secili nga produktet duhet të diskutohet dhe aprovohet nga menaxheri i Kontratës. Kompania e përzgjedhur i raporton menaxherit të Kontratës në baza mujore për progresin e punës dhe në fund të projektit e dorëzon raportin final të punëve.

AFTËSITË E KËRKUARA

- Aftësi të jashtëzakonshme në fushën e dizajnit grafik.
- Kreativitet.
- Ekspertizë në zhvillim të strategjive të brendimit dhe të komunikimit.

KRITERET E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e kontraktuesit do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Cilësia e qasjes së sugjeruar për krijimin e brandit/identitetit vizuel të rajonit të Dukagjinit;
- Portofolio e kompanisë;
- Aktiv në treg për të paktën tre (3) vjet;
- Kontraktori (kompania) duhet të ketë të paktën tre (3) vjet përvojë profesionale në brendim, menaxhim të rrjeteve sociale/marketing dhe shërbime të tjera krijuese/kreative;
- Drejtuesi i ekipit të kompanisë duhet të ketë të paktën pesë (5) vjet përvojë në brendim dhe shërbime të tjera krijuese;
- Anëtarët e ekipit duhet të kenë të paktën dy (2) vjet përvojë në branding, menaxhim të rrjeteve sociale dhe shërbime të tjera krijuese.

VLERA E KONTRATËS

Vlera e përgjithshme e kontratës për kryerjen e shërbimeve të listuara më lart është 10,000.00 EUR (dhjetëmijë euro).

DOKUMENTET QË DUHET TË DORËZOHEN

- Informata mbi kompaninë, përfshirë dokumentet e regjistrimit të biznesit, CV-të e drejtuesit të ekipit dhe anëtarëve të tjerë të ekipit të cilët do të angazhohen në krijimin e identitetit vizuel të rajonit të Dukagjinit.
- Portofolio e kompanisë, që përmban projekte të njëjta/ngjashme, të cilat do të ndihmojnë CHWB Kosovën të kuptoj kapacitetet e kompanisë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë.
- Referencat e të paktën dy (2) projekteve të mëparshme, të rëndësishme për zhvillimin e identitetit vizuel. Referencat duhet të përfshijnë informacionin e kontaktit të klientëve.

AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMIT

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e kërkuara të përmendura më lart, deri më 25.06. 2021. Dokumentet dorëzohen me email në kosovo@chwb.org apo në zyret e CHWB Kosova.